

*Interneti është më shume se një loje... është jeta jote!*

Ka disa gjëra të rëndësishme të cilat ju duhet t'i dini dhe zbatoni gjatë përdorimit të internetit

! **Mendo** përpara se të veprosh!

Silluni me përgjegjësi ndaj vetes dhe të tjerëve nëse jeni online apo në jetë reale;

! **Mendo** përpara se mund të thuash gjëra që mund të lëndojnë të tjerët online!

Gjithkush ka të drejtën të respektohet. Respektoni të tjerët ashtu siç do të donit t'ju respektonin të tjerët!

! **Mendo** përpara se të postosh online!

Kur poston diçka online ajo mund të jetë aktive përgjithmonë, pasi materiali mund të ruhet, shkarkohet dhe shpërndahet nga përdorues të tjerë të internetit;

Mendo përpara se të hedhësh të dhënat e tua personale identifikuese;

! **Mendo** përpara se të përdorësh një informacion që e gjen online!

Paraprakisht sigurohu që burimet e informacionit që shfrytëzon janë burime të sigurta.

! **Mendo** përpara se të postosh online!

Mos posto asgjë që mund të të vendosë në situatë të vështirë ty apo shokët e tu. Mund të pendohesh në të ardhmen;

Tregohu i kujdesshëm për materialet që shpërndan me shokët online. Ki parasysh që miqtë e sotëm, jo domosdoshmërisht do të jenë miqtë e tu në të ardhmen;

! **Mendo** përpara se t'i dorëzohesh presionit të bashkëmoshatarëve!

Je i/e lirë të thuash JO dhe të jesh i/e ndryshëm/e nga të tjerët. Kjo të bën unik/e;

Njerëzit jo gjithmonë janë të sinqertë për veprimet e tyre;

Refuzo kërkesat që ti i konsideron të pakëndshme ose të papërshtatshme;

! **Mendo** përpara se të qëndrosh shumë kohë në Internet!

Mos lejo që internet të ndikojë në jëtë tënde të përditshme;

Balanco aktivitetet e tua sociale me qëndrimin në internet.

@ **Mos harro**, njerëzit jo gjithmonë janë ata që thonë se janë!

@ **Mos harro**, veprimet e tua online mund të sjellin pasojat e tyre në jëtë të përditshme!

@ Nëse ndjeni nevojën për të folur me dikë për sigurinë në Internet, mund të telefononi 116 111- Linjën Kombëtare të Këshillimit për Fëmijë, mund të dërgoni email në adresën [alo116@crca.al](mailto:alo116@crca.al), mund të na shkruani në Facebook – Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë, mund të kontaktoni gjithashtu në website-t [www.alo116.al](http://www.alo116.al) dhe [www.lsigurt.al](http://www.lsigurt.al);